



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Euro Commerc OP" të datës 02.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Euro Commerc OP" të datës 02.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Euro Commerc OP" (tutje "parashtruesi") me datë 02.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i parkut sportiv dhe këndit të lodrave në lagjen 5-Prugov" me nr. të prokurimit 616-25-1614-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Gjatë rrjedhës së kësaj procedure të prokurimit, ju si Autoritet Kontraktues keni kërkuar sqarime lidhur me Dosjen e Tenderit më datë 16.05.2025, të cilat ne i kemi ofruar në kohë dhe në përputhje me kërkesat tuaja. Një nga sqarimet e kërkuara nga ana juaj ishte si vijon:

"Ju lutem për këtë pikë: automikser për prodhimin e betonit (me regjistrim valid), a mund të na sqaroni më shumë për funksionin e makinerisë që keni paraqitur dhe të na dëshmoni se i plotëson kriteret sipas kërkesës për këtë aktivitet."

Ne, si operator ekonomik, kemi ofruar sqarimin përkatës më datë 17.05.2025, ku kemi dhënë një përshkrim të detajuar të funksionit të makinerisë dhe përshtatshmërisë së saj me kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Parashtruesi me datë 17.05.2025 me kërkesën e AK ka dorëzuar sqarime shtesë përmes të cilave ka konfirmuar se në ofertën e tij ka dorëzuar një pajisje që është automikser dhe që mund të prodhojë beton. Ky fakt është konfirmuar edhe në dokumentet e ofertës së tij. Në anën tjetër dosja e tenderit ka kërkuar "një automikser për prodhimin e betonit". Në këtë drejtim, mund të thuhet se kjo kërkesë e DT është përmbushur. Hipotetësisht edhe nëse nuk do të ishte përmbushur, kjo do të përbënte definivisht devijim të vogël nëse marrim parasysh se në sqarime shtesë është theksuar po ashtu fakti që sipas paramasës betoni do të përdoret vetëm për poz. 3.4 punimi i fushës së futbollit dhe atë në pjesën ku duhet të mbushet me beton vetëm vrimat në të cilat do të bëhet ankorimi i shtyllave të rrethojës. Vlen të shtohet po ashtu që oferta e parashtruesit është dukshëm më çmim më të lirë afër 7.8% sesa oferta e tenderuesit të rekomanduar (apo 11,197.62 euro).

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar ashtu që aktiviteti të kthehet në rivlerësim.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.10.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.